



YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS  
NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
INICIJATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA

# RAPORTI VJETOR 2021

# PËRMBAJTJA

01

Kush jemi ne / Vizioni / Misioni

02

Ekipa jonë

03

YIHR-KS në 2021

04

Ngjarjet e vitit 2021

05

Programet tona

06

Programi i Ballafaqimit me të Kaluarën

Dialogu i të Rinjve Kosovar

Kampanja informuese e Parimeve mbi  
Ballafaqimin me të Kaluarën (BmK)

Pajtimi dhe transformimi i konflikteve

Të pajtosh është të përforcosh

16

---

**17**  
**33**

## **Program për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit**

Ndërtimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të drejtat e njeriut dhe rritja e edukimit për të drejtat e njeriut.

Ligjërata me përfaqësues të Dhomave të Specializuara të Kosovës

Gjuha Kundër Urrejtjes në Ballkanin Perëndimor

Rritja e qasjes në drejtësi në nivel komunal

Fuqizimi i komuniteteve, të rinjve dhe grave për një sundim efektiv të ligjit dhe qasje në drejtësi në Kosovë

Mbrojtja e të drejtave ekonomike dhe sociale gjatë dhe pas pandemisë COVID-19

---

**34**  
**36**

## **Program për Fuqizimin e të Rinjve**

Nxitja e qasjeve të reja për pajtimin e të rinjve

Shkollat Kampione për Ndryshim Social

---

**37**  
**45**

## **Aktivitetet Shtesë YIHR - KS**

Dita Ndërkombëtare e Gruas

Dita Kombëtare e Personave të Zhdukur

Java e Krenarisë

Protesta: “Drejtësi për gratë e vrara”

Protesta: “Vrasja e grave duhet trajtuar s i urgjencë kombëtare!”

Java e të Drejtave të Njeriut

Protesta: ‘Mbroj, Promovo, Protesto!’

# STATISTIKAT VJETORE 2021

Janë realizuar  
**150**  
aktivitete

**2,250**  
përfitues  
direkt

**10** MoU me  
institucione të  
ndryshme  
publike

**3**  
Protesta

**20**  
MoU me  
OJQ-të lokale

**9** grante të  
dhëna për  
OJQ-të lokale

**10** Aksione  
Rrugore

## PROGRAMI PËR BALLAFAQIM ME TË KALUARËN

**2**  
Ekspozita YEP  
**40** pjesëmarrës

**2** Programe të  
Shkëmbimit Rinor  
**54** pjesëmarrës

**25**  
Takime  
Dypalëshe

**1**  
Punëtori me Rrethin  
e Koheziv  
**30** pjesëmarrës

**1** Punëtori – Dita  
Ndërkombëtare  
e të Rinjve  
**33** pjesëmarrës

**1** World Café me  
Vendimmarrës  
**29** pjesëmarrës

**6**  
Subgrante  
SGS

**4**  
Aksione Rrugore -  
Parimet për  
Ballafaqim  
me të Kaluarën

# PROGRAMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE SUNDIMIN E LIGJIT

**1** Trajnim i Studentëve të Drejtësisë

**20** pjesëmarrës

**31** Ligjërata për Drejtësi

**400+** studentë të drejtësisë

**18** raportime të pranuar në Platformën 'E Drejta Jem'

**1**

Panel Diskutim

**60+** pjesëmarrës

**1** Gjykim i Simuluar

**32** pjesëmarrës

**2** Programe të Praktikës

**30** praktikantë

**7** Webinare 'Të rinjtë si Mbrojtës të Drejtave të Njeriut'

**3** Ditë të Gjykatës së Hapur

**87** pjesëmarrës

**1** Trajnim për qasje në dokumente publike

**7** Punëtori të Hulumtimit dhe Shkrimit Ligjor

**16** Ligjërata të Klinikës Kushtetuese dhe Administrative

**25** pjesëmarrës

**16** Simulime të Seancave të Kuvendit



# PROGRAM PËR FUQIZIMIN E TË RINJVE

**3** Ngjarje  
Shumëfishuese  
**90** pjesëmarrës

Fushatë virtuale  
kundër bullizmit  
dhe diskriminimit  
**20** shkolla  
kampionë të  
angazhuara

**1** Konferencë  
**84** pjesëmarrës

**2** Konkurse të  
Eseve  
**7** fitues çmimesh

**4** Living Libraries  
**185+** participants

**2** Punëtori të  
Rrëfimtariisë  
**40** pjesëmarrës

**2** World Cafes  
**55** pjesëmarrës

# JAVA E TË DREJTAVE TË NJERIUT



---

**» 01**

**HYRJE**



---

# KUSH JEMI NE

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) fillimisht u themelua si një organizatë joqeveritare rajonale në vitin 2003, e cila më vonë u shndërrua në një rrjet rajonal të YIHR në Kosovë, Serbi, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci.

Për mbi 17 vite, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS) ka punuar me sukses në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe vlerave demokratike jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon.

Konkretisht, YIHR KS është e fokusuar në procesin e ballafaqimit me të kaluarën, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe fuqizimin e rolit të rinisë në nivel lokal dhe rajonal.

---

## VIZIONI

Një shoqëri e lirë, e barabartë dhe e drejtë ku të gjithë njerëzit mund të realizojnë potencialin e tyre të plotë.

---

## MISIONI

YIHR KS promovon, mbron dhe avokon për të drejtat e njeriut, duke u marrë me të kaluarën, sundimin e ligjit dhe vlerat qytetare si parime fundamentale të një shoqërie të lirë, të përgjegjshme dhe progresive.



---

**» 02**

**EKIPA JONË**

---

# EKIPA JONË



**Marigona  
Shabiu**



**Bjeshkë  
Guri**



**Rina  
Kadiri**



**Enis  
Selimi**



**Trina  
Binaku**



**Vilson  
Haxholli**



**Fiona  
Haxhiislami**




**Blerta  
Mexhuani**



**Rita  
Tërstena**



**Erona  
Hajdari**



**Kaltrina  
Fejzullahu**




**Blendë  
Pira**



**Ilir  
Vitija**



**Kushtrim  
Morina**



**Agnesa  
Jashari**



**Albulena  
Uka**




**Besmira  
Selimi**



**Arnaud  
Bouting**



**Yoel  
Rivas**



**Anđela  
Mihajlović**

---

**» 03**

**YIHR-KS NĚ  
2021**

---

# YIHR-KS NË 2021

Një tjetër vit aktiv dhe i suksesshëm për YIHR KS. Me më shumë se 150 aktivitete që përfshinë drejtpërdrejt 2250 të rinj, si dhe me aktivizëm dhe përpjekje shumë të fuqishme avokuese, ne jemi shumë krenarë që po japim një kontribut thelbësor në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, progresin e pajtimit mes njerëzve, krijimin e platformave për ballafaqimin me të kaluarën dhe fuqizimin e aktivizmit të të rinjve dhe të drejtave të njeriut në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Një arritje shumë e rëndësishme për ne gjatë vitit 2021 ishte padyshim Etiketimi i Cilësisë nga programi i Korpusit të Solidaritetit Evropian, të cilin e morëm pas një procesi kompleks por emocionues. Etiketimi i Cilësisë tani do të na mundësojë të zhvillojmë programe vullnetare në bashkëpunim me organizata të tjera evropiane në mënyrë që të rinjtë nga Kosova të përjetojnë pasurinë dhe kulturat dhe komunitetet e ndryshme të vendeve të tjera.

Muzeu i Fëmijëve të Luftës është një hap më afër jetësisht dhe për këtë, ne i jemi shumë mirënjohës për bashkëpunimin konstruktiv që kemi pasur me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, e cila do të sigurojë një hapësirë të përshtatshme për Muzeun. Muzeu është në zhvillim e sipër dhe do të jetë i hapur për publikun deri në fund të vitit 2022.

Përveç fuqizimit të të rinjve dhe qytetarëve në përgjithësi si aktivistë dhe mbrojtës të të drejtave të njeriut, ne jemi shumë të përkushtuar për të mbështetur OSHC-të e tjera, në veçanti organizatat-bazë dhe ato lokale për të rinjtë. Ne kemi ofruar mbështetje për ngritjen e kapaciteteve si dhe mbështetje financiare përmes granteve direkte në shumën prej 95,000 USD për më shumë se 10 OSHC-ve në mbarë Kosovën.

Edhe pse kemi arritur rezultate të mëdha, puna dhe aktivizmi ynë do të vazhdojë. Për këtë dëshirojmë të falënderojmë aktivistët, partnerët, donatorët dhe të gjithë ata që kontribuan dhe mbështetën punën tonë gjatë vitit 2021. Lufta për barazi, drejtësi dhe paqe duhet të vazhdojë.



---

**» 04**

**NGJARJET E  
VITIT 2021**

---

# EVENTS OF 2021

## Fitorja e YIHR KS ndaj Klan Kosovës konfirmohet me vendim të Gjykatës së Apelit

Në mars të vitit 2021, pas një beteje juridike 11-vjeçare ndërmjet YIHR KS dhe Klan Kosovës, Gjykata e Apelit i ka dhënë sërish të drejtë YIHR KS, duke e konsideruar padinë e Klan Kosovës për shpifje si të pabazuar pasi YIHR KS kishte ngritur shqetësimin se televizioni po favorizonte një parti të caktuar politike përmes një raporti të publikuar.

## Rezistencë kundër dhunës

Në nëntor të vitit 2021, parashtrimi dhe monitorimi i YIHR KS i rastit të Tomë Gashit (Avokat) u përmyll me dënim me pagesë ndaj avokatit për veprime joetike dhe shkelje të rënda të detyrave dhe autorizimeve të avokatit. Edhe pse YIHR KS nuk e konsideron dënimin të përshtatshëm për shkeljen e kryer, kjo megjithatë tregon një histori suksesi për YIHR KS e cila mban përgjegjëse çdo personazh publik apo institucion për sjellje joetike apo shkelje të të drejtave themelore të njeriut.

## Rregullimi i martesës së të njëjtit seks në Kodin Civil

YIHR KS vazhdoi punën e saj avokuese në draft Kodin Civil së bashku me OSHC-të tjera për të kërkuar që çështjet e ngritura nga shoqëria civile të adresohen në mënyrë të duhur. Procesi afatgjatë i avokimit është ende në vazhdim për shkak të trajtimit përjashtues të komunitetit LGBTIQ+ dhe përjashtimit të kërkesave për përdorimin e gjuhës neutrale në rregullimin e martesës. YIHR KS do të vazhdojë të përdorë të gjitha mjetet dhe mekanizmat ligjore dhe institucionale për harmonizimin e Kodit Civil në përputhje me Kushtetutën dhe të drejtat e garantuara në rendin tonë kushtetues dhe juridik.

---

**» 05**

**PROGRAMET  
TONA**

---

# PROGRAMET TONA

## PROGRAMI PËR BALLAFAQIMIN ME TË KALUARËN

YIHR KS vazhdon të kontribuojë duke krijuar dhe mbajtur platforma për ballafaqim me të kaluarën si dhe iniciativa për ndërtimin e paqes në të gjithë rajonin. Ky program fokusohet në mbështetjen e iniciativave dhe ndërgjegjësimin e njerëzve, veçanërisht të të rinjve, për të kaluarën e afërt në Kosovë në veçanti dhe në Ballkan më gjerësisht. Ne synojmë të ndërtojmë dhe ruajmë kujtesën kolektive dhe të kontribuojmë në proceset e ndërtimit të paqes.



## PROGRAM PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE SHTETI I LIGJIT

YIHR KS mbetet një organizatë lidere në fushën e të drejtave të njeriut në Kosovë. Që nga viti 2004, YIHR KS ka punuar në monitorimin dhe raportimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, duke avokuar për zbatimin e ligjeve dhe funksionimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kështu, YIHR KS synon të vazhdojë të jetë një mbrojtëse dhe promovuese aktive e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe në rajon.



## PROGRAM PËR FUQIZIMIN E TË RINJVE

YIHR KS beson në fuqinë e të rinjve si qytetarë të përgjegjshëm dhe aktiv në ndërtimin e një shoqërie të drejtë, të barabartë dhe paqësore. Prandaj, fokusi kryesor i këtij programi është i dyfishtë. Së pari, është fuqizimi i të rinjve për t'u bërë pjesëmarrës aktiv në jetën shoqërore dhe politike në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe global nëpërmjet edukimit formal dhe joformal. Së dyti, është për të forcuar kapacitetet e të rinjve në angazhimin, mbrojtjen dhe avokimin e të drejtave të njeriut për të gjithë dhe në angazhimin në proceset e ballafaqimit me të kaluarën.





---

**» 06-16**

**PROGRAMI I  
BALLAFAQIMIT  
METË  
KALUARËN**

---

# PROGRAMI I BALLAFAQIMIT ME TË KALUARËN

## Projekti:

### Dialogu i të Rinjve Kosovar

Dialogu i të Rinjve Kosovar është një projekt 30-mujor me qëllim kryesor fuqizimin e të rinjve për të marrë pjesë në mënyrë aktive në proceset për ballafaqim me të kaluarën dhe pajtimin në Kosovë duke inkurajuar komunikimin, ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndëretnik, adresimin e interesave të përbashkëta, ndërtimin e besimit, dhe promovimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe qëndrimeve pozitive.

## Programi i Shkëmbimit të të rinjve

Rreth 54 të rinj të moshës 16-30 vjeç nga komuniteti shqiptar dhe serb shfrytëzuan mundësinë për të marrë pjesë në 2 nga Programet e Shkëmbimit të të Rinjve (YEP) ku patën mundësinë të pajisen me njohuri për çështjet e ballafaqimit me të kaluarën dhe pajtimin.

Të rinjtë patën rastin të vizitojnë monumente të ndryshme nga lufta e fundit në Kosovë dhe të diskutojnë për kujtesën kolektive. Përveç kësaj ata punuan në 4 grupe tematike dhe u angazhuan në shfaqje teatrale, fotografi, prodhim video dhe storytelling për të krijuar bashkërisht projekte të udhëhequra nga mentorë profesionistë. Detyra e tyre ishte t'i përdornin këto forma arti si një mjet për dialog dhe bashkëpunim me njëri-tjetrin, si dhe një mënyrë për të kundërshtuar bashkërisht narrativat nacionaliste që ekzistojnë në shoqëritë tona dhe në të njëjtën kohë për të promovuar pajtimin.

Pas përfundimit të shkëmbimit, pjesëmarrësit/et patën mundësinë të ekspozojnë punimet e tyre për publikun e gjerë përmes Ekspozitave YEP.






---

## Ekspozita YEP

Rreth 40 të rinj nga komuniteti shqiptar dhe serb në Kosovë shfaqën projektet e tyre të përbashkëta artistike në 2 Ekspozitat e Programit të Shkëmbimit të të Rinjve (YEP) të mbajtura në Prishtinë dhe në Mitrovicë.

Gjatë këtyre ekspozitave, të rinjtë së bashku folën para publikut të gjerë për përvojën e tyre në YEP 4 me shokët/shoqet e tyre me prejardhje të ndryshme dhe rëndësinë e bashkëpunimit në sfidat e përbashkëta si të rinj.



---

## Muzeu i Fëmijëve të Luftës

Në janar, YIHR KS njoftoi iniciativën e Muzeut të Fëmijëve të Luftës i cili do të shfaqë rrëfimet e fëmijëve që përjetuan luftën e fundit në Kosovë përmes sendeve të tyre personale, dëshmime audio-vizuale, lodrave, ditarëve dhe sendeve të tjera personale. Qëllimi kryesor i kësaj nisme është të përmirësojë kujtesën kolektive për luftën e fundit në Kosovë si një mënyrë për t'u përballur me të kaluarën, si dhe të zhvillojë një qasje kritike ndaj narrativave nacionaliste përmes hulumtimit dhe dokumentimit të përvojave dhe tregimeve të kohës së luftës.

Muzeu është ende në proces të themelimit dhe pritet të hapet në fund të vitit 2022 në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës 'Pjetër Bogdani'.



## Skema e granteve të vogla

Këtë vit, cikli i dytë i Skemës së Granteve të Vogla u implementua nga YIHR KS me mbështetjen e USAID-it. Kjo skemë ofroi 3 grante për 6 OJQ me një total prej 60000\$.

Përfituesit e skemës ishin:

Udruženje mladih - Mlada aktivna Gračanica dhe Fondacioni për Informim, Media, Dialog dhe Edukim KosovaLive.

NewPerspektiva dhe Communication for Social Development

Radio Vala Rinore dhe Human Rights Radio Network

Këto OJQ punojnë së bashku drejt përmirësimit të bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet të rinjve me prejardhje të ndryshme në Kosovë, me fokus të veçantë tek të rinjtë nga komuniteti shqiptar dhe serb. Qëllimi i kësaj skeme është të mbështesë financiarisht OJQ-të që punojnë me grupe të ndryshme etnike në mbështetjen e procesit të pajtimit në Kosovë duke u fokusuar në çështjet e drejtësisë tranzicionale, ballafaqimit me të kaluarën dhe ndërtimin e paqes përmes projekteve të tyre.



---

## World Cafe me Vendimmarrës

Gjatë këtij aktiviteti, 29 të rinj dhe të reja patën mundësinë të bisedojnë me vendimmarrës, të diskutojnë ide dhe shqetësime, si dhe të shprehin nevojat e tyre si të rinj për t'u bërë aleatë me vendimmarrësit për ngritjen e kapaciteteve për të rinjtë, kontributin e tyre në procese të pajtimit dhe promovimit të mëtejshëm të paqes mes bashkëmoshatarëve të tyre.



---

## Projekti:


### Kampanja informuese e Parimeve mbi Ballafaqimin me të Kaluarën (BmK)

---

## Aksione Rrugore

Të vetëdijshëm për ndikimin negativ të deklaratave dhe veprimeve të dëmshme mbi viktimat, të mbijetuarat dhe gjithë procesin e ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë, YIHR KS organizoi 4 aksione rrugore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan dhe Prizren për të promovuar Parimet mbi Ballafaqimin me të Kaluarën në mbarë Kosovën, kështu që publiku i gjerë të ketë qasje në parime të tilla që synojnë të udhëzojnë akterët politikë, mediat dhe publikun se si të trajtojnë më së miri viktimat, të mbijetuarit, të kaluarën e dhimbshme dhe narrativat historike të luftës në Kosovë. Përmes instalimit të xhamit dhe fletoreve të vogla që përmbajnë parimet, YIHR KS mundi të promovojë më tej parimet dhe të diskutojë me qytetarët se si kjo nismë synon të parandalojë dominimin e narrativave të njëanshme dhe t'u ofrojë viktimave dhe të mbijetuarve respektin dhe drejtësinë që meritojnë.






## Kampanja e Parimeve të Bmk në Kosovë

Në dhjetor, YIHR KS inicioi një kampanjë në rrjete sociale e cila tregoi secilin nga 10 parimet e nismës së Parimeve mbi Ballafaqimin me të Kaluarën përmes pankartave të mbajtura nga të rinjtë që tregojnë mirëkuptimin dhe mbështetjen e tyre për mesazhet dhe objektivat që kjo nismë shfaq për publikun e gjerë.







## Projekti: Pajtimi dhe transformimi i konflikteve

Qëllimi i aktivitetit të Pajtimin dhe Transformimit të Konflikteve (RCT) në Kosovë është të adresojë nevojat aktuale të pajtimin ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në Kosovë në nivel individual, komuniteti dhe institucional. Ky projekt zbatohet nga CBM me partnerët NSI dhe YIHR KS dhe mbështetet nga populli amerikan përmes USAID-it në Kosovë.

### Takime Bilaterale

Gjatë vitit 2021 janë organizuar 25 takime me grupe të interesit, me njerëz nga fusha dhe prejardhje të ndryshme si gazetarë, aktivistë, organizata joqeveritare, përfaqësues nga qeveria, pronarë biznesi etj. nevojat e pajtimin ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në Kosovë në nivel individual, komunitar dhe institucional dhe aktivitetet që do të mbahen si pjesë e projektit.

### Punëtori me Rrathët e Kohezionit

Qëllimi i punëtorive ishte që aktivistët me prejardhje të ndryshme dhe influencues të komunitetit të takoheshin reciprokisht me njëri-tjetrin, të diskutonin ngjarjet e komunitetit dhe të inicionin ide. 30 pjesëmarrës nga komunitetet shqiptare, serbe dhe të tjera joshumicë në Kosovë u mbledhën dhe diskutuan për çështje të ndryshme që kishin në komunitetin e tyre dhe biseduan për zgjidhjet. Disa nga idetë e dala nga kjo punëtori ishin që të mbillen 50 pemë në rajonin e Mitrovicës dhe të bashkëpunohet me shkollat e këtij rajoni.



## Shpëto Planetin - Aktiviteti i Komunitetit

Duke qenë se çështja e mjedisit të ndotur është e çështje e përbashkët për të gjitha komunitetet, ekipi i projektit u pajtua që të shënojë Ditën e Tokës si ngjarjen përfundimtare të paraparë në kuadër të javës së aktivizmit në shtatë komuna të rajonit të Mitrovicës. Ceremonia e mbajtur nga datat 19-22 prill ngriti ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe përfaqësuesve të komuniteteve nga shtatë komuna për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe ajrit të pastër. Kjo ngjarje përcolli mesazhin e pajtimit dhe paqes në mes të komuniteteve duke sjellë vëmendjen ndaj sfidave dhe problemeve të përbashkëta që të gjitha komunitetet ndajnë kur bëhet fjalë për mjedisin.

Gjithsej, Konferenca Java e Tokës dhe Save the Planet kishte 296 pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, ndërsa disa mijëra qytetarë të Kosovës dëgjuan për iniciativën përmes mediave, mediave sociale dhe aktiviteteve të komunikimit me komunitetin.



## Dita Ndërkombëtare e Rinisë

Me një punëtori njëditore shënuam Ditën Ndërkombëtare të Rinisë më 12 gusht, e cila mbledhi së bashku 33 të rinj nga komunitete të ndryshme për të diskutuar mbi procesin e pajtimit përmes një diskutimi në grup dhe aktiviteteve/lojërave të ndryshme. Aktivitetet u fokusuan në inkurajimin e pjesëmarrësve që të flasin për sfidat dhe të diskutojnë alternativat për procesin e pajtimit në Kosovë.



---

## Projekti: Të pajtosh është të përforcosh

Projekti “Të Pajtosh është të Përforcosh” u implementua nga YIHR Serbi, YIHR Bosnjë dhe Hercegovinë, YIHR Kosovë dhe YIHR Mali i Zi me mbështetjen e Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Objektivi i këtij projekti ishte të ndërtonte një mjedis më të sigurt, më të gjerë dhe më efektiv për organizatat e shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor me hapësirë të gjallë qytetare dhe lidhje të forta rajonale.

---

## Takime me OJQ-të, OQ-të dhe institucionet shtetërore

YIHR KS me të gjitha organizatat e tjera implementuese kanë hulumtuar shembuj të praktikave të mira të punës bashkëpunuese ndërmjet OSHC-ve dhe institucioneve shtetërore në kuadër të kulturës së kujtesës në vendet e synuara. Mbi 12 takime janë zhvilluar me palët e interesuara për të identifikuar praktikat dhe çështjet përkujtimore në punën bashkëpunuese ndërmjet organizatave dhe institucioneve shtetërore. YIHR KS ka mbajtur gjithsej 6 takime: Dy me OSHC-të lokale — konkretisht Iniciativa e Re Sociale (NSI) dhe INTEGRA; Një me IGO - OSBE; Tre me institucionet shtetërore — përkatësisht Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore dhe Personat e Pagjetur, Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës (IAP) dhe Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale.

---

## Analizimi dhe monitorimi i praktikave përkujtimore në rajon

YIHR KS, si dhe zyrat e tjera, kanë bërë analiza mbi praktikat aktuale dhe të kaluara të përkujtimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. YIHR KS së bashku me zyrat e YIHR në Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi kanë monitoruar praktikat përkujtimore në vendet e tyre përkatëse nga janari 2021 deri në tetor 2021. Rezultati i këtyre analizave dhe monitorimit ishte Raporti Ndërrajonal për Praktikën Përkujtimore, dhe Manuali i politikave të propozuara të përkujtimit publik dhe praktikave të mira në Ballkanin Perëndimor.

---

## Kampanja e Avokimit

Gjatë gjithë vitit, YIHR KS mbajti një kampanjë në mediat sociale me qëllim ndërtimin e besimit të publikut dhe përmirësimin e dialogut qytetar. Në total, YIHR KS ka postuar rreth 45 masakra që kanë ndodhur në Kosovë gjatë periudhës 1998-2000. Nëpërmjet këtyre postimeve, YIHR KS ka kujtuar të gjitha viktimat e luftës dhe konfliktit pa dallim kombësie, gjinie apo feje.



## Zhvillimi i Komunitetit

YIHR Serbia, YIHR Bosnja dhe Hercegovina, YIHR Kosova dhe YIHR Mali i Zi mbajtën një takim konsultativ rajonal, një seminar rajonal dhe një konferencë të përbashkët përmbyllëse online për të nxitur bashkëpunimin rajonal.

Takimi konsultativ rajonal u mbajt në Mal të Zi, ku pjesëmarrësit folën për praktikën ekzistuese rajonale që synojnë identifikimin e mangësive dhe pengesave që ndikojnë në bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore. Punëtorja me OSHC-të rajonale u mbajt në Beograd. Ky seminar u fokusua në nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe promovimin e hapësirës qytetare.

Ngjarja përmbyllëse e këtij projekti ishte konferenca online që synonte OSHC-të kryesore, institucionet shtetërore, IGO-të dhe institucionet e BE-së për mbledhjen e komenteve për përmirësimin e mjedisit operativ të OSHC-ve të Ballkanit Perëndimor. Gjatë kësaj konference YIHR Serbia dhe YIHR Kosovë prezantuan gjetjet e raportit ndër-rajonal mbi përkujtimet, si dhe manualin e politikave të propozuara përkujtimore publike dhe praktikave më të mira në Ballkanin Perëndimor. Tridhjetë e pesë pjesëmarrës u bashkuan kësaj konference dhe dhanë komentet e tyre.

---

**» 17-33**

**PROGRAM PËR  
TË DREJTAT  
E NJERIUT DHE  
SUNDIMIN E LIGJIT**

---

# PROGRAM PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE SUNDIMIN E LIGJIT

## Projekti: Ndërtimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të drejtat e njeriut dhe rritja e edukimit për të drejtat e njeriut.

Ky projekt mbështetet nga UNMIK/OHCHR dhe synon të arrijë tek njerëzit anembanë Kosovës me fokus në Mitrovicën e Veriut, Vitin/Vitia dhe Hanin e Elezit/Đeneral Janković. Ky projekt synon të ofrojë një platformë për dialogun ndërmjet komuniteteve ndërmjet përfaqësuesve të ndryshëm nga OSHC-të e të drejtave të njeriut përmes takimeve të rregullta koordinuese dhe konsultative, si dhe deklaratave të përbashkëta të avokimit të të drejtave të njeriut dhe demarsheve me institucionet e Kosovës; për të ndërtuar kapacitetet monitoruese dhe raportuese të të drejtave të njeriut të OSHC-ve, veçanërisht mbi implikimet e pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut; për të lehtësuar prodhimin, shpërndarjen dhe promovimin e e raportit të tretë të përbashkët vjetor të të drejtave të njeriut të shoqërisë civile; dhe për të përmirësuar edukimin për të drejtat e njeriut, veçanërisht mbi ndikimin e pandemisë COVID-19.

## Rrjeti i të Drejtave të Njeriut (HRN)

Në Ditën e të Drejtave të Njeriut - 10 Dhjetor 2021, u krijua një rrjet prej shtatë organizatash i njohur si Rrjeti i të Drejtave të Njeriut (HRN). Ky rrjet po punon së bashku në avancimin e mëtejshëm të të drejtave të njeriut për të gjithë në Kosovë. Anëtarët e HRN janë: Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS), Shoqata e Paraplegjikëve dhe Fëmijëve të Paralizuar të Kosovës (HAND-IKOS), Qendra për Barazi dhe Liri (CEL), Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGGK), Iniciativa e Re Sociale (NSI) dhe Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (VoRAE).

Si organizata të shoqërisë civile në Kosovë, organizatat anëtare qëndrojnë në vijë të frontit të luftës për të siguruar që të drejtat dhe liritë e njeriut të përmbushen për të gjithë njerëzit, veçanërisht për grupet më të cënueshme, si gratë, personat LGBTI, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet e jo shumicë, fëmijët dhe të rinjtë. Këto OSHC do të luajnë një rol kritik në analizimin, monitorimin, raportimin dhe avokimin për realizimin e të drejtave të njeriut në Kosovë.

OSHC-të në këtë rrjet u zotuan të angazhohen për të vazhduar aktivizmin e tyre të përbashkët drejt zvogëlimit të pabarazive, luftimit të padrejtësive dhe kërkimit të llogaridhënies dhe përgjegjësisë nga institucionet e Kosovës në respektimin e të drejtave të njeriut për të gjithë. OSHC-të u zotuan të promovojnë një qasje më kohezive dhe gjithëpërfshirëse ndaj monitorimit, raportimit dhe avokimit të të drejtave të njeriut, duke inkurajuar kështu partneritetet dhe forcimin e hapësirës qytetare në Kosovë. Në fillim të vitit 2022, HRN do të mbajë tre punëtori për Ngritjen e Kapaciteteve për të Drejtat e Njeriut për OSHC-të bazë si dhe do të publikojë Raportin e tretë të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.



## Raporti Vjetor i OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë

YIHR KS — në emër të HRN — kishte kontaktuar mbi 100 OSHC për të japur kontributet e tyre për Raportin e OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021. HRN gjithashtu mbajti një seancë konsultative me OSHC-të që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Pjesë e këtij takimi ishin 11 OSHC, ku iu prezantua faqosja e raportit të vitit 2020. Këto organizata u informuan me kujdes se si mund të kontribuonin në këtë raport. YIHR KS, në emër të HRN, shtoi sugjerimet e tyre të cilat do të jenë pjesë e raportit të tretë.

Deri në fund të vitit 2021, HRN kishte mbledhur 42 inpute nga 22 OSHC nga e gjithë Kosova. Të gjitha këto të dhëna janë përfshirë në draftin e parë të raportit. YIHR KS ka angazhuar dy redaktorë për të shkruar raportin. Këta redaktorë përfunduan draftin e parë të raportit dhe po punojnë për mbledhjen e më shumë informacioneve për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë për periudhën janar 2021-dhjetor 2021. Raporti do të publikohet në mars 2022.



## “Biblioteka të Gjalla”

Më 10 dhjetor, Ditën e të Drejtave të Njeriut dhe ditën e fundit të Javës për të Drejtat e Njeriut, YIHR KS organizoi të parën ‘Bibliotekën e Gjallë’ në Viti. “Librat” ishin aktivistët, të cilët folën për aktivizmin e tyre për të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrësit ishin “lexuesit”. 45 të rinj dhe të reja patën mundësinë të rrisin njohuritë e tyre mbi të drejtat e njeriut dhe aktivizmin dhe të informohen e të fuqizohen për të ngritur të drejtat e tyre dhe të drejtat e bashkëmohatarëve të tyre.

Edukimi për të drejtat e njeriut, veçanërisht përmes formateve angazhuese dhe ndërvepruese si bibliotekat e gjalla, e bën pikërisht këtë duke promovuar vlera, besime dhe qëndrime që inkurajojnë të gjithë individët të mbrojnë të drejtat e tyre dhe të tjerëve duke zhvilluar një kuptim të përgjegjësisë së përbashkët të secilit për të bërë të drejtat e njeriut një realitet në çdo komunitet. Living Library (Biblioteka e Gjallë) funksionon si një bibliotekë normale, ku një lexues zgjedh librin që dëshiron të lexojë. Megjithatë, në Living Library, çdo libër është një aktivist me përvojë që ndan aktivizmin e tyre afatgjatë.




## Projekti: Të Rinjtë për Drejtësi

“Të rinjtë për Drejtësi” është një projekt i mbështetur nga Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara/INL që është zbatuar në rajonet e Prishtinës, Gjakovës, Pejës, Ferizajit gjatë vitit 2020. Qëllimi i këtij projekti është fuqizimi i të rinjve për të qenë aktivë në sektorin e drejtësisë në Kosovë. Projekti “Të Rinjtë për Drejtësi” deri më tani ka angazhuar më shumë se 2000 të rinj nga komunitete të ndryshme në dymbëdhjetë komuna. Gjatë kësaj kohe kemi mbuluar disa çështje të rëndësishme për shoqërinë kosovare si ngritja e vetëdijes për të drejtën e informimit për qytetarët, vendosja dhe mbajtja e një procesi dialogu ndërmjet institucioneve gjyqësore dhe qytetarëve, si dhe ngritja e kapaciteteve profesionale për avokatët e rinj.

## Platforma ‘E drejta jem’

Gjatë vitit 2021, ekipi i YIHR KS ka vazhduar të promovojë platformën “E drejta jem” në të gjitha aktivitetet. Qëllimi i kësaj platforme është fuqizimi i të rinjve në sektorin e drejtësisë, ndërgjegjësimi i të rinjve për llogaridhënien dhe transparencën dhe ngritja e njohurive të tyre për të drejtat e njeriut dhe institucionet e drejtësisë në Kosovë përmes përmbajtjes që përmban.





Platforma ofron gjithashtu një seksion "Raporto ose Pyet" ku publiku i gjerë mund të raportojë një rast ose të pyesë për një rast në të cilin të drejtat e njeriut janë shkelur. YIHR KS do të kërkojë llogaridhënie nga institucionet përkatëse dhe do t'i monitorojë ato për veprime apo mosveprime lidhur me pyetjet/rastet e raportuara. Gjatë gjithë vitit kemi pranuar 18 raporte të cilat janë adresuar nga ekipi organizativ tek institucionet përkatëse. Në disa raste YIHR KS ka mundur të krijojë komunikim ndërmjet reporterëve dhe institucioneve përkatëse, ndërsa shumë qytetarë janë këshilluar që t'i deklarojnë pretendimet e tyre tek autoritetet kompetente dhe për procedurat ligjore që mund të ndërmerren.

## Trajnimi i Studentëve të Drejtësisë

Në tetor, 20 studentë të drejtësisë ishin pjesë e trajnimit të organizuar me qëllim përgatitjen e tyre për të mbajtur ligjërata mbi sistemin e drejtësisë dhe të drejtat e njeriut për studentët e shkollave të mesme dhe universitetet. Trajnimi u zhvillua nga një profesionist ligjor dhe u fasilitua nga YIHR KS.



## Ligjërata për drejtësi

YIHR KS organizoi një numër të përgjithshëm prej 31 ligjëratah me më shumë se 400 pjesëmarrës nga studentë të shkollave të mesme dhe universiteteve në rajonin e Prishtinës, Pejës, Gjakovës dhe Ferizajit. Programi për Edukimin për të Drejtat e Njeriut ka trajnuar 20 studentë të drejtësisë për të mbajtur ligjërata informative dhe për të bashkëvepruar me studentët mbi institucionet e të drejtave të njeriut dhe drejtësisë në Kosovë.



---

## Partneritet me OJQ-të bazë

YIHR KS signed six MoUs with grassroots organizations in six target regions in order to establish a cooperation in promoting and protecting human rights. The aforementioned NGOs are “Activism Roots” in Gjakova, “Syri i Visionit” in Peja, “Vullnetaret e Qytetit” in Gjilan, “Kuvendi i te Rinjve te Ferizaj” in Ferizaj, “REC” in Mitrovica, and “THY” in Prizren.

---

## Gjykime të Simuluara Lokale

Në Nëntor 2021, YIHR KS mbajti aktivitetin Gjykime të Simuluara Lokale me nxënës të shkollave të mesme nga rajoni i Prishtinës. Gjithsej 32 të rinj morën pjesë në aktivitet dhe morën informacione për të drejtat e njeriut, sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe simuluan një seancë gjyqësore duke luajtur rolin e një gjyqtari, një prokurori dhe një avokati.




---

## Panel diskutimi

Me qëllim të shënimit të Ditës së Kushtetutës më 9 Prill 2021 në kuadër të ngjarjes virtuale “Lansimi i aplikacionit - My Rights”, YIHR KS mbajti një panel diskutimi me më shumë se 60 pjesëmarrës me temën “Sfidat në sistemin e drejtësisë dhe mbrojtja e të drejtave kushtetuese gjatë pandemisë” me zëvendëskryeprokuroren e shtetit Sevdije Morina, drejtorin e Departamentit Ligjor në Këshillin Gjyqësor të Kosovës Astrit Hoti dhe Avokatin e Popullit të Kosovës Naim Qelaj.

Panelistët folën për sfidat me të cilat u përballën gjatë periudhës së pandemisë, duke vënë theksin në mbrojtjen e të drejtave të njeriut gjatë masave kufizuese. Eventi ngriti interesin e të rinjve pasi kishin shumë pyetje në lidhje me masat e marra për mbrojtjen e të drejtave të njeriut veçanërisht gjatë pandemisë.



## Programi i praktikës

Në mars të vitit 2021, 10 praktikantë të vendosur në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Pejë, Gjakovës dhe Ferizajt përfunduan praktikën gjashtëmujore. Praktikantët fituan njohuri në praktikë duke bashkëpunuar ngushtë me gjyqtarë në departamente të ndryshme dhe ishin pjesë e seancave gjyqësore. Me qëllim të vazhimit të bashkëpunimit me Gjykatën Themelore dhe ofrimit të përvojës praktike për studentët e drejtësisë, në nëntor të vitit 2021 është nënshkruar një memorandum me Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Prandaj është bërë i mundur punësimi i 20 praktikantëve në gjykatën themelore në shtatë regjione. Duke bërë këtë, YIHR KS ka ofruar një mundësi të jashtëzakonshme për të rinjtë e Kosovës, veçanërisht për studentët e drejtësisë dhe të diplomuarit e drejtësisë.

Praktikantët, përveçse ndjekën punën e përditshme të kryer në një institucion gjyqësor, patën mundësinë të ndihmojnë gjykatat në detyrat e tyre të përditshme. Më e rëndësishmja, ata patën mundësinë të ndiqnin aktivitetet e përditshme të një profesionisti ligjor dhe të mësonin se si të raportojnë shkelje etike, profesionale dhe ligjore kur dhe nëse ishin dëshmitarë të ndonjë shkeljeje.





## Ditët e Gjykatës së Hapur

Gjatë gjithë vitit, YIHR KS mbajti 3 Ditë të Gjykatës të Hapur ku 87 nxënës të shkollave të mesme patën mundësinë të vizitojnë Gjykatat Themelore të Gjakovës, Pejës dhe Ferizajt. Studentët e rinj patën mundësinë të takojnë gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë të ndryshëm, nga të cilët kanë dëgjuar raste interesante dhe të mësojnë më shumë për punën e gjyqtarëve, procedurat administrative dhe se si ka ndikuar pandemia në punën e tyre.

Të rinjtë kishin shumë pyetje interesante në lidhje me sistemin e drejtësisë pasi shumë prej tyre ishin në vitin e fundit të shkollës së mesme dhe treguan interes për të studiuar drejtësi.



## Projekti: Gjykatat e Specializuara të Kosovës

YIHR KS në bashkëpunim me Dhomat e Specializuara të Kosovës organizoi 6 ngjarje informative gjatë vitit 2021. Rreth 130 nxënës të shkollave të mesme dhe universiteteve u informuan për strukturën, kompetencat dhe lëndët që janë duke u gjykuar në Dhomat e Specializuara të Kosovës. Këto manifestime do të vazhdojnë të mbahen edhe në vitet në vijim me qëllim të informimit sa më të mirë të qytetarëve për mandatin e Gjykatave të Specializuara të Kosovës.



## Projekti: Gjuha Kundër Urrejtjes në Ballkanin Perëndimor

Në vitin 2021, në bashkëpunim me organizatat rajonale, YIHR KS filloi zbatimin e projektit “Gjuha Kundër-Urrejtjes në Ballkanin Perëndimor”. Pavarësisht se diskriminimi ndaj grupeve të marginalizuara dhe gjuha e urrejtjes kanë qenë të përhapura në Ballkanin Perëndimor gjatë krizës së Covid-19, është e qartë se ndërgjegjësimi i publikut për forma të ndryshme të diskriminimit, si dhe mundësia e parandalimit dhe mbrojtjes së tyre, është e ulët, veçanërisht në dritën e një krize të paprecedentë shëndetësore. Në vitin 2021, YIHR KS kreu një analizë të situatës për gjuhën e urrejtjes në Kosovë dhe është duke punuar në një projekt tjetër hulumtues në lidhje me gjuhën e urrejtjes në media ndaj grupeve më të cenueshme si minoritetet etnike, gratë, pakicat seksuale, (LGBTI) dhe minoritetet e pafavorizuara shoqërore (personat me aftësi të kufizuara, individët/grupet me të ardhura të ulëta), të cilat do të përfshihen në dokumentin e përbashkët rajonal.



## Projekti: “Rritja e qasjes në drejtësi në nivel komunal”

“Rritja e qasjes në drejtësi në nivel komunal” është një projekt 12-mujor që synon të përmirësojë aksesin në drejtësi në nivel lokal duke aktivizuar dhe përfshirë të rinjtë dhe organizatat bazë si promovuese të sundimit të ligjit dhe demokracisë. Ky projekt ka dhënë grante të vogla për 6 OJQ vendore në vlerë prej 35000\$ në total. Përmes këtij projekti, ne kemi synuar të krijojmë dhe të nxisim bashkëpunimin dhe komunikimin shumë të nevojshëm ndërmjet niveleve të ndryshme të palëve të interesuara të sistemit të drejtësisë dhe administrative në Kosovë.

## Programi i Praktikës


YIHR KS ka nënshkruar gjithsej 6 Memorandume Bashkëpunimi me komunitat e Ferizajit, Pejës, Gjakovës, Prizrenit, Gjiçanit dhe Mitrovicës së Jugut.

Qëllimi i këtyre memorandumeve është lehtësimi i qasjes në hapësirat publike të komunës dhe akomodimi i praktikantëve në administratën komunale të secilës komunë. 23 studentë të drejtësisë u vendosën me sukses ose në komunitat e synuara ose në zyrat e avokatisë për të përfunduar programin e praktikës.



## Trajnimi: "Qasja në dokumente publike"

Trajnimi "Qasja në dokumente publike" u mbajt me ligjëruesen Flutura Kusari, e cila është juriste e së drejtës mediatike dhe eksperte në fushën e sundimit të ligjit dhe studentë të Fakultetit Juridik – Universiteti i Prishtinës. Në trajnim u diskutuan mënyrat për të siguruar akses në shikimin, pranimin dhe ripërdorimin e dokumenteve publike, të cilat si e drejtë themelore kontribuojnë në zhvillimin dhe forcimin e institucioneve demokratike dhe transparente të shoqërisë bashkëkohore. Në veçanti u diskutua për shkëlqet ligjore që bëjnë institucione të ndryshme publike në praktikën e mosdhënies së aksesit në dokumente publike.





## Klinika Kushtetuese dhe Administrative

Gjithsej 16 ligjërata u organizuan gjatë zbatimit të projektit dhe ekipi angazhoi profesorë, asistentë mësimdhënës dhe praktikantë të ligjit për të mbajtur ligjëratat.

Duke ruajtur natyrën e larmishme të ligjëratave, YIHR KS mbajti ligjërata mbi konceptet bazë të së Drejtës Administrative më pas vazhdoi me praktikat e nivelit lokal si dhe vendimet e gjykatave në lidhje me Konfliktin Administrativ për 25 të zgjedhur për të marrë pjesë në kurs dhe praktikë.

Klinika ishte e ndarë në këto pjesë tematike:

- 1 Procesi i vendimmarrjes në nivel komunal dhe kontrolli hierarkik i këtij procesi;
- 2 Kontrolli i jashtëm dhe gjyqësor i procesit të vendimmarrjes në nivel komunal;
- 3 Vlerësimi përfundimtar dhe procedura e inicimit të lëndës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Çdo temë është e kategorizuar në nënçështje specifike që janë diskutuar dhe do të diskutohen gjatë kursit, në mënyrë që studentët të përgatiten për programin e tyre të praktikës.



## Punëtoritë e Hulumtimit dhe Shkrimit Ligjor

Gjithsej 198 të rinj përfituan nga 7 punëtoritë të mbajtura gjatë muajve maj dhe qershor.

Gjatë këtyre punëtorive, pjesëmarrësit fituan njohuri për sistemin juridik dhe shtetëror të Kosovës përmes udhëzimeve hap pas hapi se si të kryhen hulumtime juridike. Punëtoritë vazhdoi me analizimin e rasteve të ndryshme nga gjykatat e Kosovës. Këto punëtoritë kontribuan në rritjen e efikasitetit, transparencës, llogaridhënies dhe profesionalizmit të shërbimeve juridike brenda administratave komunale përmes mbështetjes profesionale.





## Simulimi i seancave të Kuvendit

Më shumë se 350 të rinj të moshës 16-24 vjeç nga 16 komuna të ndryshme patën mundësinë të marrin pjesë në trajnimin simulues të Sesioneve të Kuvendit Komunal ku mësuan më shumë për funksionimin dhe rolin e Kuvendit, si dhe u ndanë në role të ndryshme për të simuluar një sesioni.

Bazuar në reagimet e pjesëmarrësve dhe organizatorëve të trajnimit, simulimi i seancave të Kuvendit rezultoi të ishte një nga aktivitetet më interesante dhe më intriguese të projektit.





## Gara të Eseve

Me qëllim të stimulimit të të menduarit kritik tek të rinjtë, për të zgjuar kreativitetin e tyre dhe për të përcaktuar opinionin e tyre për çështjet e drejtësisë, YIHR KS përmes grantmarrësve të saj aktiv në rajone të ndryshme, hapi një Konkurs Ese me temën "Pse ekziston korrupsioni?" Nga 63 esetë e pranuar, tre esetë më të mira nga çdo rajon u shpërblyen me libra.



## Takimi Reflektues - Klinika Kushtetuese dhe Administrative

Në qershor, YIHR KS në bashkëpunim me Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës ka mbajtur një takim me studentët e lëndës semestrare jashtëshkollore "Klinika Kushtetuese dhe Administrative" dhe përfituesit e praktikës, ku kanë ndarë përvojat e tyre dhe mësimet e nxjerra gjatë gjithë programit të praktikës dhe klinikës.



---

## Konferenca përmbyllëse

Në shtator, YIHR KS organizoi konferencën përmbyllëse të projektit me palët e interesuara dhe përfituesit. Në këtë konferencë, YIHR KS mbajti edhe një panel diskutimi me temë "Pjesëmarrja e të rinjve në zgjedhjet e ardhshme lokale" me Prof. Dr. Visar Morina nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Eugen Cakolli nga Demokracia në Veprim dhe Blerina Ukshini nga Demokracia për Zhvillim. Diskutimet u ngritën mbi rëndësinë e integritetit të të rinjve në vendimmarrjen publike dhe qeverisjen vendore.



---

## Projekti: "Fuqizimi i komuniteteve, të rinjve dhe grave për një sundim efektiv të ligjit dhe qasje në drejtësi në Kosovë"




"Fuqizimi i komuniteteve, të rinjve dhe grave për një sundim efektiv të ligjit dhe qasje në drejtësi në Kosovë" është një projekt edukativ pesë-mujor i zhvilluar nga YIHR KS në bashkëpunim me OJQ-në Njohuri Sociale për Përgjegjësi dhe Transparencë të Vërtetë - OJQ "SOKRAT" me seli në Partesh/sh. Projekti do të zbatojë një qasje gjithëpërfshirëse teorike dhe praktike në edukimin e nxënësve të shkollave të mesme për t'u bërë agjentë të fuqizuar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe proceseve të ndërtimit të paqes në Kosovë.

---

## Seria e webinarëve "Të rinjtë si mbrojtës të të drejtave të njeriut"

YIHR KS në bashkëpunim me NVO Sokrat, të mbështetur nga UNDP Kosova, mbajtën me sukses 7 webinarë informative dhe interaktive mbi të drejtat e njeriut dhe sfidat e komunitetit me të rinjtë nga komuniteti serb në Kosovë.

Trajnimi dyditor interaktiv angazhoi rreth 22 të rinj në Kosovë me qëllim njohjen e tyre me konceptin e të drejtave të njeriut si dhe përmirësimin e të menduarit të tyre kritik për identifikimin, adresimin dhe zgjidhjen e çështjeve të komunitetit. Përveç njohjes së tyre me mekanizmat ligjorë dhe institucionalë në Kosovë që mbrojnë dhe garantojnë drejtpërdrejt të drejtat e jo-shumicës, YIHR KS synoi t'u tregojë pjesëmarrësve se YIHR KS mbetet e përkushtuar në krijimin e një hapësire të sigurt dhe të shoqërisë gjithëpërfshirëse për njerëzit nga të gjitha komunitetet në Kosovë.



## World Café

Aktiviteti World Café mbledhi së bashku më shumë se 50 të rinj nga komunitete të ndryshme në Kosovë.

Në shkurt, 25 pjesëmarrës nga seria e webinarëve “Të rinjtë si mbrojtës të të drejtave të njeriut” patën rastin të takohen personalisht dhe të diskutojnë tema të ndryshme nga mësimet e nxjerra gjatë trajnimit. Të ndarë në 4 grupe etnikisht të ndryshme, ata diskutuan mbi çështje të rëndësishme si e drejta për gjuhën, të drejtat e komuniteteve joshumicë, të drejtat e LGBTQ+ dhe të drejtat e grave në World Café-n e parë. Më vonë, më 20 maj, u mbajt World Café e dytë me rreth 30 pjesëmarrës.






## Konkursi i Esesë

YIHR KS në bashkëpunim me organizatat partnere NVO Sokrat, UNDP Kosovë dhe UNICEF mbajtën një ceremoni përmbyllëse online të projektit “Fuqizimi i komuniteteve, të rinjve dhe grave për një sundim efektiv të ligjit dhe qasje në drejtësi në Kosovë”.

Ceremonia filloi me fjalën e hapjes nga z. Niels Knudsen, Zëvendës Përfaqësues i Përhershëm i UNDP-it dhe më pas nga znj. Larissa Bruun, zëvendës shefe e zyrës së UNICEF-it, e cila foli për punën e UNICEF-it për fuqizimin e të rinjve. Znj. Marigona Shabiu dhe z. Stefan Stojanović ndanë gjithashtu përvojën e tyre mbi partneritetin dhe bashkëpunimin multietnik rinor të OJQ-ve.

Gjatë kësaj ceremonie, YIHR KS shpalli 4 fituesit e konkursit për esenë më të mirë me temë “Të drejtat e njeriut dhe qasja në drejtësi” me fokus në të drejtat e grupeve të marginalizuara dhe zgjidhjet e mundshme të problemeve me të cilat ballafaqohen komunitetet e ndryshme në Kosovë. Të rinjtë që vinin nga komunitete të ndryshme pranuan punën e tyre individuale ose u bashkuan për të shkruar së bashku për çështje të tilla që i prekin dhe i interesojnë.



## Projekti: "Mbrotjtja e të drejtave ekonomike dhe sociale gjatë dhe pas pandemisë COVID-19" - UNMIK - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Projekti "Mbrotjtja e të drejtave ekonomike dhe sociale gjatë dhe pas pandemisë COVID-19" synoi të ndërtojë rezultatet nga ndërhyrjet e kaluara duke fuqizuar pjesëmarrësit të ngrihen për të drejtat e njeriut të bashkëmoshatarëve të tyre nga komunitete të ndryshme, duke kontribuar kështu në përpjekjet më të gjera të ndërtimit të besimit dhe pajtimit përmes aktivitete interaktive dhe novatore për të drejtat e njeriut, duke përfshirë një kamp tregimi, një turne me autobus, biblioteka të gjalla dhe pamje të ndryshme komunikimi.

### "Bibliotekat e Gjalla"

Më shumë se 140 të rinj morën pjesë në "Bibliotekat e Gjalla" në Kamenicë, Ferizaj dhe Lipjan për të mësuar mbi të drejtat ekonomike dhe sociale duke lexuar dhe dëgjuar historitë e njëri-tjetrit si libra.

Bibliotekat e gjalla u mundësuan të rinjve të ndajnë historitë e tyre gjatë pandemisë nga e cila dolën shumë mesazhe frymëzuese.



**Ferizaj**



**Kamenicë**





Lipjan



## Fushata virtuale për të Drejtat Ekonomike dhe Sociale

Për të promovuar të drejtat e njeriut dhe ndërtimin e besimit, u organizua një fushatë në internet me mesazhe kyçe për të drejtat e njeriut. Për t'u fokusuar në të drejtat ekonomike dhe sociale gjatë pandemisë, YIHR KS ndau postime që shfaqnin të drejtat thelbësore të njeriut si qasja në kujdesin shëndetësor gjatë pandemisë, siguria gjatë pandemisë dhe liria gjatë pandemisë.

### WHICH ARE SOME OF MY ECONOMIC AND SOCIAL RIGHTS?

#### RIGHT TO AN ADEQUATE STANDARD OF LIVING RIGHT TO SOCIAL PROTECTION

- The right to food, water, clothing and housing.
- The right to social assistance, social security and social insurance.



This project has been funded by UNHCR.



### WHICH ARE SOME OF MY ECONOMIC AND SOCIAL RIGHTS?

#### RIGHT TO WORK AND WORKER'S RIGHTS RIGHT TO EDUCATION

- The right to safe and healthy working conditions.
- The right to available and accessible secondary and higher education, progressively made free of charge.



This project has been funded by UNHCR.



### WHICH ARE SOME OF MY ECONOMIC AND SOCIAL RIGHTS?

#### RIGHT TO HEALTH

- The right to access health facilities, goods and services.
- The right to healthy occupational and environmental conditions, and protection against epidemic diseases.



This project has been funded by UNHCR.



---

**34-36**

**PROGRAM PËR  
FUQIZIMIN E  
TË RINJVE**

---

# PROGRAM PËR FUQIZIMIN E TË RINJVE

## Projekti: Nxitja e qasjeve të reja për pajtimin e të rinjve

YIHR KS me projektin “Nxitja e qasjeve të reja për pajtimin e të rinjve” promovon pajtimin dhe ndërton besimin në mesin e të rinjve të vendit.

## Punëtoritë e Storytelling (rrëfimtariisë)

Në maj 2021, YIHR KS zbatoi Punëtorinë e parë të Storytelling (rrëfimtariisë), ku 20 pjesëmarrës nga komunitete të ndryshme në Kosovë patën mundësinë të mësojnë më shumë rreth ballafaqimit me të kaluarën dhe rëndësinë e aktivizmit dhe tregimit. Për më tepër, ata mësuan se si të zhvillojnë intervista për Muzeun Virtual të Refugjatëve. Punëtorja e dytë u mbajt gjatë datave 17-20 qershor me 20 pjesëmarrës, shumë prej të cilëve për herë të parë hasën në bashkëveprime me të rinj nga komunitetet tjera që jetojnë në Kosovë.



## Ngjarjet Shumëfishuese

Në kuadër të projektit “Common Ground Common Future”, YIHR KS organizoi 3 ngjarje shumëfishuese që u përfshinë në hartimin e projektit me qëllim të shpërndarjes së rezultateve të projektit në mënyrë të fortë. YIHR KS ndau vizionin tonë me 90 pjesëmarrës lokalë duke prezantuar rezultatet e rasteve studimore dhe Paketën e Instrumenteve të “Common Ground Common Future” bazuar në përmbledhjen e studimeve dhe zhvillimit të teorive dhe qasjeve.





## Konferenca 'Common Ground Common Future'

Kjo konferencë ishte pjesë e strategjisë afatgjatë të përhapjes. YIHR KS ndau rezultatet përfundimtare dhe vizionin tonë me pjesëmarrësit (gjithsej 84, 60 nga Norvegjia, 24 nga të gjitha vendet e tjera partnere) duke prezantuar verzionet përfundimtare të Paketës së Instrumenteve dhe Udhëzimeve, metodologjinë e vlerësimit të përdorur dhe formësuar për këtë projekt (pjesë e IO8), dhe versionin përfundimtar të portalit (IO9), duke përfshirë rezultatet e të gjitha IO-ve të tjera, dhe duke ftuar palët e interesuara, aktorët lokalë në ndërtimin e komuniteteve të forta, të qëndrueshme, të respektueshme dhe zyrtarë qeveritarë dhe delegatë ndërkombëtarë bashkëpunues.



## Projekti: 'Shkollat Kampione për Ndryshim Social'

Ky projekt synon të rrisë cilësinë e arsimit duke rritur bashkëpunimin ndërmjet të gjithë aktorëve të arsimit përmes përdorimit të përditshëm të mjeteve jo të dhunshme. Aktivitetet në kuadër të këtij projekti janë realizuar në bashkëpunim me 20 shkolla fillore kampione në mbarë Kosovën, të përzgjedhura nga GIZ CDBE.

## Fushata virtuale kundër bullizmit dhe diskriminimit

Në shkurt, YIHR KS filloi Fushata Virtuale Kundër Bullizmit dhe Diskriminimit si pjesë e projektit të Shkollave Kampione për Ndryshime Sociale të mbështetur nga GIZ Kosova në emër të Qeverisë Gjermane.

Qëllimi i kësaj fushate ishte ndërgjegjësimi i të gjithë qytetarëve, veçanërisht të rinjve, për rëndësinë e promovimit të narrativave personale dhe mjeteve jo të dhunshme që mund të përdoren në shkolla.

Përmbajtja e kësaj fushate tregonte iniciativat kundër bullizmit që kanë zbatuar 20 shkollat kampione në mbarë Kosovën dhe publikohej çdo ditë në orën 19, nga data 15 shkurt deri më 6 mars 2021.





---

**37-44**

---

**AKTIVITETET  
SHITESË  
YIHR - KS**

---

# AKTIVITETET SHITESË - YIHR - KS

## Dita Ndërkombëtare e Gruas

YIHR KS në mbështetje të thirrjes 'Marshojmë S'festojmë', më 8 Mars shënoi Ditën Ndërkombëtare të Gruas duke marshuar për të treguar rezistencën tonë ndaj patriarkatit që vazhdon të marrë jetën e shumë grave në Kosovë. Në këtë ditë, YIHR KS përkujtoi të gjitha gratë që u vranë vetëm pse ishin gra dhe kërkuan dhe do të vazhdojnë të kërkojnë drejtësi dhe barazi.



## Dita Kombëtare e Personave të Zhdukur

1639 emra që i mungojnë Kosovës për 21 vite!

Më 27 prill, YIHR KS shënoi Ditën Kombëtare të Personave të Zhdukur përmes një instalacioni në sheshin "Skenderbeu" në të cilin u vendosën të gjithë emrat e të pagjeturve nga lufta e fundit në Kosovë. Përmes këtij aksioni në rrugë u kërkua drejtësi në emër të bashkëqytetarëve tanë dhe familjeve të tyre dhe YIHR KS tregoi zhgënjimin me përpjekjet e shtetit për zbardhjen e fatit dhe vendndodhjes së personave të zhdukur për më shumë se dy dekada.

Po ashtu, në ora 20:00, YIHR KS u bëri thirrje të gjithë qytetarëve dhe sheshit të Prishtinës që të fikin dritat për 5 minuta për t'u solidarizuar me dhimbjen e familjarëve që vazhdojnë të presin në errësirë. U krijuan video të ndryshme dhe u shpërndanë storje të rrjeteve sociale me hashtag-un #inthedarknessofmissingpeople.



## Java e Krenarisë

Si pjesë e grupit punues, YIHR KS mbështeti Javën e Krenarisë (28 qershor - 1 korrik) këtë vit duke bashkëorganizuar ngjarje të shumta së bashku me CEL Kosovë dhe CSGD Kosovë. Java e Krenarisë këtë vit synoi të nxjerrë në dritë çështjen e Kodit Civil dhe martesave të të njëjtit seks. Përmes sloganit "Së bashku dhe krenarë", YIHR KS bëri thirrje për solidaritet, barazi, drejtësi dhe ndryshime shoqërore. Më 1 korrik u mbajt Parada e 5-të e Krenarisë me një marshim nëpër rrugët e Prishtinës. YIHR KS qëndron në solidaritet dhe vazhdon të mbështesë, avokojë dhe rezistojë së bashku me miqtë tanë queer në luftën për liri, pranim dhe barazi!



## Protesta: “Drejtësi për gratë e vrara”


Concerned and aggravated by the case of the murder of an 18-year-old girl in Ferizaj, on August 24th YIHR KS protested together with the organizers and citizens in front of the Police Station and Prosecution and Basic Court in Ferizaj under the slogan "Justice for the murdered women!" with a request that justice is carried out immediately by punishing the suspects and demanding that such cases not be repeated again!



## Protesta: “Vrasja e grave duhet trajtuar si urgjencë kombëtare!”

Përmes kësaj proteste, YIHR KS në bashkëpunim me organizatat QIKAT, Rrjetin e Grave të Kosovës dhe Qendrën Kosovare për Studime Gjinore kërkuan që vrasja e grave të trajtohet si urgjencë kombëtare. Kjo thirrje e 26 gushtit erdhi si pasojë e vrasjes makabre që ndodhi në Ferizaj, rast që na kujtoi edhe një herë se jeta e grave dhe vajzave në Kosovë është në rrezik të vazhdueshëm. Prandaj, të shqetësuar për gjendjen e pasigurt të vajzave dhe grave dhe dhunën që ushqehet nga institucionet shtetërore, YIHR KS protestoi kolektivisht pranë institucioneve shtetërore në Prishtinë.







**HUMAN  
RIGHTS  
WEEK**

**VOL. 8**

**6-10 DHJETOR, 2021**



# Java e të Drejtave të Njeriut

Edicioni i 8-të i Javës së të Drejtave të Njeriut (6-10 dhjetor) këtë vit ishte i jashtëzakonshëm duke marrë parasysh zbatimin e gjithsej 14 aktiviteteve të ndryshme. Nën sloganin 'Mbroni TË DREJTAT, Promovoni AKTIVIZMIN, Protestoni PADREJTËSITË', YIHR KS synoi të sjellë vëmendjen në llogaridhënien e institucioneve për rastet e shkeljeve arbitrare të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe gjithashtu u fokusua në rëndësinë jetike të aktivizmit dhe rezistencës në shoqërinë tonë, kundër shkeljeve të të drejtave themelore të njeriut.

## ACTIVITIES

<p><b>06</b> December</p> <p>10:00 – 12:00 Conference – 'Institutional responsibility for human rights'</p> <p>15:00 Awareness Raising Video – Domestic Violence</p> <p>19:00 – 21:30 Party • DJ Genc Elezaj – 'Servis'</p>	<p><b>07</b> December</p> <p>17:00 – 19:00 Exhibition Virtual Museum of Refugees – 'National Museum of Kosovo'</p> <p>19:00 – 20:00 Human Rights Movie Night – 'Foundation 17'</p>	<p><b>08</b> December</p> <p>10:00 – 13:00 World Café with Decision Makers</p> <p>14:00 – 18:00 Workshop 'Activism and Hope'</p> <p>19:00 – 21:30 Drag Show – 'ODA'</p>	<p><b>09</b> December</p> <p>10:00 – 12:00 Discussion: 'Corruption and Human Rights' – 'Sirius Hotel'</p> <p>15:00 Video – Corruption effect on Human Rights</p> <p>22:15 – 23:15 'Jeta në Kosovë' TV program - 'What is happening to human rights in Kosovo?'</p>	<p><b>10</b> December</p> <p>10:00 – 13:00 Living Library - 'Viti'</p> <p>12:00 – 13:00 Street Actions throughout 6 regions of Kosovo</p> <p>12:00 – 13:00 Protest in Prishtina - Protect, Promote, Protest! – 'Zahir Pajaziti Square'</p>
---	--	---	--	--



Organizer:  Partners:     Donors:    

## Konferenca - "Përgjegjësia Institucionale për të Drejtat e Njeriut"



## Nata e Filmit për të Drejtat e Njeriut



## Punëtorja - "Aktivizmi dhe Shpresa"



## Diskutim - "Korrupsioni dhe të Drejtat e Njeriut"






## World Cafe me Vendimmarrës



## Ekspozita 'Larg Shpisë' me Artan Hajrullahu



## Drag Show me HYJNESHAT




## Aksione Rrugore në 6 rajonet e Kosovës



## Protesta: 'Mbroj, Promovo, Protesto!'

Më 10 dhjetor 2021 në ora 12:00 në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, YIHR KS në bashkëpunim me organizatat CEL, RrGGK, IKD, VoRAE, HANDIKOS ftuan të gjithë aktivistët dhe qytetarët që të mblidhen në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë në protesta kundër padrejtësive dhe dhunës institucionale. Njëkohësisht me këtë protestë u përmyll edhe edicionin e 8-të të 'Javës së të Drejtave të Njeriut' të shënuar nga YIHR KS.

Nëpërmjet kësaj proteste paqësore, YIHR KS njëzëri kërkoi nga institucionet përgjegjëse që të përmbushin përgjegjësitë e tyre ligjore dhe të marrin masa urgjente në mbrojtjen, respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë pa dallim. Nën sloganin "Mbroj TË DREJTAT, Promovo AKTIVIZMIN, Protesto PADREJTËSITË", qytetarët iu bashkuan protestës në solidaritet me të gjitha viktimat e shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.



**Mbroj,  
TË DREJTAT,** **Promovo,  
AKTIVIZMIN,** **Protesto  
PADREJTËSITË**



YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS  
NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
INICIJATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA